



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:227049  
Datë: 08.08.2024  
Numri i dokumentit: 06033344

**AC-I-23-0206**

***Në ankesën e***

***Paditësi/ankuesi***

**R G, Prishtinë.**

***kundër***

***E paditura***

**NSH, "Mirusha"** (në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Driton Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Imi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-0935 të datës 23 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 08 gusht 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë i DHPGJS-së, C-IV-15-0935 i datës 23 mars 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me 02 qershor 2015, paditësi ka paraqitur ankesë pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (në vazhdim: AKP), me të cilën ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në vazhdim: AL), PEJ068-0313, të datës 07 maj 2015. Ka theksuar se ka kërkuar nga AL, pagesën për pagat e papaguara për periudhën 1991-01.06.1999. Autoriteti i Likuidimit kërkesën e parashtruar e ka refuzuar mbi bazën e parashkrimit të kërkesës. Pretendon se thirrja në institutin e parashkrimit është i gabuar dhe se përbën aplikim të gabuar të dispozitave materiale juridike. Ka shtuar se në vitin 1991, kundër masës së shkëputjes nga marrëdhënia e punës ka parashtruar ankesë pranë Gjykatës së Punës së Bashkuar dhe se pas shuarjes së Gjykatës së Punës së Bashkuar këtë kontest nga marrëdhënia e punës e ka vazhduar pranë Gjykatës Komunale në Klinë. Gjykata Komunale në Klinë në lidhje me këtë çështje e ka pezulluar procedurën. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta miratoj si të bazuar, ta anuloj vendimin e Autoritetit të Likuidimit dhe t'i njihet e drejta në kompensimin e pagave të pa paguara në lartësinë prej 15,133.64 €. Padisë ia ka bashkangjitur vendimin me numër PEJ068-0313, të AL.

Me 20 qershor 2022, e paditura ka paraqitur përgjigje në ankesë, e cila ka theksuar se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL, respektivisht përputhshmëria e tij me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Me nenin 74.2 të atij ligji është përcaktuar se ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034. Më tutje, ka ngritur edhe prapësimin e parashkrimit të kërkesës, duke theksuar se me padi kërkohen pagat duke filluar nga viti 1999, ndërsa me nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, është përcaktuar se kërkesat apo pretendimet e pas afatshme, sipas kufizimeve kohore të aplikueshme, do të refuzohen si të pa baza. Përveç kësaj, paditësi e ka lëshuar vendin e punës në vitin 1991-1999 dhe nuk ka afruar shërbime si punëtorë, prandaj edhe nuk i takojnë të ardhura personale – paga për periudhën kohore në të cilën nuk ka punuar. Me përgjigje në padi është propozuar të refuzohet kërkesëpadia, si dhe të vërtetohet vendimi i lëshuar nga AL.

Me 31 tetor 2022, pala paditëse ka parashtruar përgjigje në përgjigje në padi, në të cilën ndër të tjera ka theksuar: aplikimi i masave të dhunshme nga ana e Kuvendit të Republikës së Serbisë ka pasur për qëllim largimin e punëtorëve shqiptar nga marrëdhënia e punës. Largimi i tij nga puna është bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe të dhunshme me prezencë të forcave policore. Edhe në përgjigje në përgjigje në padi ka theksuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës.

Me 01 shkurt 2023, gjykata e ka urdhëruar paditësin që në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit të dorëzojë në gjykatë aktgjykimin P.br.283/91 dhe shkresat e bashkëngjitura të asaj lënde. Meqenëse urdhri në fjalë nuk ka mundur t'i dorëzohet palës paditëse në adresën e dhënë në padi, gjykata ka urdhëruar afishimin e urdhrit në tabelën e shpalljeve të DHPGJS.

Me 23 mars 2023, Shkalla e parë e DHPGJS, me Aktgjykimin C-IV-15-0935, e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e AL PEJ 068-0313, të datës 07 maj 2015, si të drejte dhe të bazuar në Ligj. Shkalla e parë ka arsyetuar se, çështja e parë që është dashur të zgjidhë gjykata ishte ajo se a është kërkesa e parashkruar apo jo. Tutje ka arsyetuar se pas shqyrtimit të dosjes së lëndës ka ardhur në përfundimin se nga faktet e treguara apo të prezantuara nga pala paditëse në padi, e që nuk janë kontestuar si të tilla as nga pala e paditur, nuk del themelësia e kërkesëpadisë. Përkundrazi, mbi bazën e të gjitha fakteve siç i ka prezantuar pala paditëse në padi rezulton se kërkesëpadija nuk është e bazuar, për shkakun se kërkesa është e parashkruar. Pala paditëse, me kërkesën kreditore drejtuar AL-së dhe me kërkesëpadi ka kërkuar kompensimin e pagave të papaguara që i takojnë periudhës kohore 1991-1999. Nga ana tjetër, kërkesën kreditore për kompensim pagash e ka dorëzuar në AL me datën 03 mars 2015. Shkolla e parë tutje ka arsyetuar se sikurse legjislacioni që ishte vendosur para viteve 1998/99, ashtu edhe ligjet që janë miratuar pas viteve 1998/1999, e kanë ruajtur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit të kërkesave monetare nga lëmi i marrëdhënies së punës. Me Ligjin për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), neni 608 parashihej se *"pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, do të jetë e parashkruar për tri vite"*. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i vitit 1978 (Ligj nr. 690), neni 372.1 përcaktonte se *afati i parashkrimit të kërkesave periodike është tri vite, nga rrjedhja*

*e secilës dhënie të veçantë për pagesë. Ligji i Punës, i vitit 2010 (Ligj nr. 03/L-212), neni 87, përcakton se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Edhe LMD i ri, i vitit 2012 (Ligj nr. 04/L-077), neni 353.1, ka përcaktuar se "Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ... parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë". Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, rezulton se afati i parashkrimit të kërkesave monetare nga marrëdhënia e punës, është tri vite, nga dita e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç. Padiësi nuk ka prezantuar ndonjë të dhënë apo informacion se ka pasur ndonjë ngjarje juridike në ndërkohë, që eventualisht do të kishte ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit.*

Shkalla e parë po ashtu ka arsyetuar se padiësi kërkon pagat për një periudhë në të cilën nuk ka qenë i angazhuar në procesin e punës në Ndërmarrje. Paga është rezultat e procesit të punës dhe i krijimit apo zhvillimit të fondit të Ndërmarrjes, ku pastaj një pjesë e atij fondi shpërndahet për pagat e punëtorëve të përfshirë në procesin e punës. Me që padiësi nuk ka qenë punëtorë i Ndërmarrjes që nga viti 1991-1999 dhe nuk ka qenë i angazhuar në punë, nuk janë prodhuar as të drejta dhe detyrime reciproke në mes tij dhe Ndërmarrjes, në aspektin e pagave.

Pala padiëse se në vitin 1992 ka pretenduar se ka parashtruar një padi në Gjykatën Komunale në Klinë, për kthim në vendin e punës dhe kjo padi është evidentuar me numrin C.nr.283/92, mirëpo kjo lëndë nuk është përfunduar me vendim meritor. Pala padiëse nuk ka sqaruar dhe nuk ka ofruar dëshmitë nga lënda gjyqësore në fjalë, për të vërtetuar në këtë kontest, se ajo lëndë ka përfunduar. Në parashtrësën me shkrim të datë. 31 tetor 2022, padiësi ka theksuar se ka bërë kërkesë për kopje të lëndës C.nr.283/92, në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Klinë, por nuk ka arritur të gjejë lëndën personeli gjyqësor. Rrjedhimisht pala padiëse nuk ka arritur të dëshmoj se ka fituar ndonjë të drejtë në relacion me vendimin e ndërmarrjes për shkëputjen e marrëdhënies së punës në ndërmarrje.

Me 07 prill 2023, padiësi/ankuesi dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-0935, me të cilën ka propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të hedhet poshtë aktgjykimi i gjyqtarit individual të DHPGJS, të datës 23 mars 2023 dhe të veprojë konform dispozitave ligjore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Kolegjit të Apelit ka shtuar se Vendimi i Autoritetit të Likuidimit ka qenë unik (i njëjtë për të gjithë), i shabllonizuar, mohues, i pa njohur dhe i pa marrë parasysh kushtet dhe rrethanat juridike që e kanë karakterizuar kohën dhe hapësirën kosovare në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar pa e analizuar secilin rast veq e veq, gjë që ka rezultuar të jetë i pavlefshëm dhe si i tillë i paligjshëm. Ky vendim ka treguar jo kompetencën profesionale të Autoritetit të Likuidimit i paligjshëm. Ky vendim ka treguar jo kompetencën profesionale të Autoritetit të likuidimit dhe mosgatishmërinë për t'u ballafaquar denjësisht me gjendjen reale të saja kohe dhe orientimin që edhe lëndët jo kontestuese t'i lehen në barrë gjykatës për t'i vendosur. Si provë e ka bashkangjitur Vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Tutje ka shtuar se është vërtetuar gabimisht gjendja faktike, e bazuar në Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, i cili thotë: nuk ka asnjë provë përpara këtij Autoriteti të Likuidimit që parashtruesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë Gjykate apo organi tjetër kompetent përpara datës 31 dhjetor 2007.

Tutje thekson se Aktvendimi i gjykatës Komunale të Klinës me padinë e tij P,br.283/92 tregon qartë se ka ushtruar padi kundër largimit tim të dhunshëm nga puna, në afatin ligjor, në vitin 1991 në Gjykatën e Punës së Bashkuar në Gjakovë, lëndë e cila pas suprimimit të Gjykatës të Punës së Bashkuar me ligjet serbe, ka kaluar në kompetencë të Gjykatës Komunale dhe mban regjistrin e Gjykatës Komunale të Klinës P,br.283/92. Pra, lënda është regjistruar në vitin 1992 në Gjykatën Komunale të Klinës. Në këtë Gjykatës është mbajtur edhe seanca e shqyrtimit të kësaj lënde me: Gjqqtarë-B V, paditës - R G, përfaqësues i të paditurës "Mirusha" organi i dhunshëm ia ndërron emrin nga Mirusha në Modul 2000) R T. Prandaj, është i gabueshëm dhe si i tillë i paqëndrueshëm fakti se nuk ka ushtruar kërkesë në afatin ligjor, në vitin 1991, në gjykatën e atëhershme kompetente. Ndërsa pas luftës deri në procesin e privatizimit (2006)- Likuidimit, me q`rast ndërmarrja shoqërore nuk është më e punëtorëve, por e ka ndërruar pronarin, nuk ka pasur arsye për të ushtruar ndonjë kërkesë për kompensimin e pagave të viteve 1991-1999, sepse ky Kompensim do të duhej të bëhej nga mjetet e shitjes së ndërmarrjes. Po të mos shitej Ndërmarrja, ne kishim vendosur që shumica e këtyre pagave të shndërrohej në aksione të punëtorëve në pronësi të Ndërmarrjes. Si provë e ka bashkangjitur Aktvendimin e gjykatës Komunale të Klinës P,br.283/92.

Vendimi i organit të dhunshëm (i quajtur si organ i përkohshëm) për shkëputen e marrëdhënies së punës tregon se: Marrëdhënia e tij e punës është shkëputur pa pëlqimin e tij. Prandaj nuk ka të bëjë me lëshime dëshirë të vendit të punës, as me mungesa nga puna, as me shqiptimin e masave disiplinore, as me mosshfrytëzim të së drejtës për punë, por me largim të dhunshëm nga puna, me mohim të drejtës për punë. Gjykata potencon edhe faktin se paditësi kërkon pagat për një periudhë në të cilën nuk ka qenë i angazhuar në procesin e punës në Ndërmarrje dhe tautologji të tjera. Përballë kësaj shtrohet pyetja çka ka ndodhë me investimet tona për zgjerimin e bazës ekonomike të Ndërmarrjes, sa është rritur ai kapital, kush i ka kthyer kreditë bankare për zgjerimin e bazës ekonomike e tjera: Zgjerimi i bazës ekonomike dhe kthimi i kredive bankare është bërë nga të ardhurat e Ndërmarrjes, nga produkti i punëtorëve, gjë që shpesh ka dikuar në shtangim apo zvogëlim të ardhurave personale mujore të punëtorëve. Për këtë, kjo çështje meriton trajtim dhe kualifikim ndryshe, më të thellë. Prandaj, ky postulat i Aktgjykimit përmban vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Si provë e ka bashkangjitur: Vendimin për shkëputjen e marrëdhënies së punës.

Tutje ka shtuar se nuk ka përfunduar zgjidhja e kontestit dhe se nuk ka fituar të drejtën e kthimit në punë apo të kompensimit të pagave sipas padisë se tij në Gjykatën e Klinës tregon politiken dhe judikaturën e koordinuar dhe unike shtypëse. Tutje paditësi ka shtuar se për mos gjetjen e lëndës në Degën e Gjykatës themelore në Klinë, duhet të merrte në konsideratë fakti se ka ushtruar Kërkesë me shkrim me datën 28 tetor 2022, dhe prej asaj date e deri më sot nuk ka marrë vendim kurrfarë përgjigje edhe pse kërkesa dhe përgjigja në këtë rast janë të natyrës administrative. Një gjendje e këtillë e mos regjistrimit, mos klasifikimit dhe mos arkivimit të lëndëve gjyqësore dhe një qasje e këtillë ndaj kërkesave të qytetarëve, 23 vjet pas luftës është vërtet rast i pa precedent. Por, kjo rrethanë është objektive, jo subjektive, prandaj konsideron se nuk mund ta dëmtoi atë.

Më 22 shkurt 2024, Kolegji i Apelit ka lëshuar Urdhër për AKP e cila mund të parashtrojë përgjigje por e njëjta nuk ka parashtuar deri në marrjen e këtij vendimi.

## **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e të paditësit është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

## **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej 15,133.64 euro, për periudhën nga viti 1991 deri më 01 qershor 1999, me vendimin e AL PEJ068-0313 të datës 07 maj 2015, ishte refuzuar si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa për paga të papaguara, është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në DHPGJS e kishte ankimuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PEJ068-0313, të datës 07 maj 2015, duke e konsideruar se kërkesa për paga nuk është parashkruar, dhe se AL me rastin e zbatimit të nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP, dhe Ligji të punës së Bashkuar gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale, ashtu që kishte kërkuara që ti kompensohen pagat e papaguara.

Me 23 mars 2023, Shkalla e parë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-15-0935, e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe kishte vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PEJ068-0313, të datës 07 maj 2015, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi ka dështuar të dorëzojë prova në mbështetje të kërkesës dhe prova për të vërtetuar ndërprerjen e parashkrimit, andaj është i saktë konstatimi i Autoritetit të Likuidimit dhe i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa për paga për periudhën e cekur është parashkruar. Paditësi e ka respektuar afatin

procedural duke e paraqitur kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit me datë 29 tetor 2013, por në at kohë kërkesa e paditësit për paga ishte e parashkruar.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet pretendimet e paditësit në ankesën e parashtruar pranë Kolegjit të Apelit i cili pretendon se kërkesa e tij nuk është parashkruar për shkak se nga Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Klinë C.nr. 283/92 me të cilën atij i është pezulluara procedura tregon qarte se ai ka ushtruar padi kundër largimit të tij nga puna.

Kolegji i Apelit konsideron se nuk është kontestuese se paditësi kishte parashtruar padi për kthimin në punë në Gjykatën Komunale në Klinë dhe se kishte filluar procedura gjyqësore në këtë çështje juridike. Por nga Aktvendimi C.nr.283/92 i bashkangjitur vërehet qartë se me këtë aktvendim procedura kontestimore e paditësit ishte pezulluar nga data 22 prill 1997 konform nenit 216 dhe 217 të Ligjit për procedurën kontestimore të vitit 1977 dhe se kundër këtij aktvendimi kishte të drejtë ankese paditësi në fat prej 8 ditësh. Kolegji i Apelit vëren se dispozita e nenit 216 në bazë të cilave Gjykata kishte marr Aktvendim për pezullimin e procedurës i referohen çështjeve kur palët në procedurë nuk marrin pjesë në seancë dhe se pala e tjetër propozon pezullimin e procedure, ndërsa paragrafi 3 nenin 217 parashihte që në qoftese asnjëra pala në afatin prej 6 muajsh prej datës së pezullimit të procedurës nuk paraqet propozim për vazhdimin e të njëjtës, konsiderohet se padia është e tërhequr. Këto informata ishin të përfshira në aktvendimin C.nr.283/92.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi as në shkallë të parë dhe as në shkallë të dytë nuk ka bashkangjitur ndonjë shkresë se paditësi e ka ankimuar këtë Aktvendim dhe se ka kërkuar vazhdimin e procedurës në Gjykatën Komunale në Klinë brenda 3 muajve nga pezullimi i së njëjtës. Andaj çështje juridike e paditësit me ligj konsiderohet e tërhequr deri sa paditësi nuk i ka prezantuar shkallës së parë dëshmi për vazhdimin e saj dhe se në këtë rast afati për përshkrim ka filluar të rrjedh përsëri, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi tjetër që mund të këtë ndërpre parashkrimin e kërkesës për paga.

Nga kjo që u tha me lartë Kolegji i Apelit vlerëson se paditësi/ankuesi ka dështuar ta respektoj afatin prej tri viteve, brenda të cilit mund të kërkohet e drejta në paga. Paditësi është dashur të kërkoj përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo



muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Paditësi kërkon kompensimin e pagave të pa paguara nga 1991 deri me 01 qershor 1999. Kjo kërkesë e paditësit është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar, që i bie se afati i parashkrimit për pagën e fundit ka arritur në korrik të vitit 2002, ndërsa paditësi kërkesën e ka parashtruar me 29 tetor 2013, që do të thotë jashtë çdo afati të paraparë ligjor.

Prandaj nga këto arsye ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 30 euro me datë 23 qershor 2023, për procedurën ankimore andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 08 gusht 2024.

Mr.Sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_